



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:072092

Datë: 12.06.2023

Numri i dokumentit: 04384329

**SCC-10-0126**

*Paditësi*

**R (M) H Gjakovë.**  
*Përfaqësuar nga Xh M, av nga Klina.*

*Kundër*

*E paditura*

**1.NSH ERENIKU “Prodhimtaria Primare”** përfaqësuar nga  
**Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Shkelzen Sylaj dhe Diellza Hoxha gjyqtarë, pas seancës dëgjimore të mbajtur me 05 qershor 2023 dhe seancës vendimmarrëse me 12 qershor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**PËR MOSPARAQITJE**

- 1. Padia e paditësve hedhet poshtë.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 11 qershor 2010, paditësi dorëzoi në Dhomën e Posaçme, padi kundër të paditurës NSH ERENIKU “Prodhimtaria Primare” në Gjakovë, me të cilën kërkoi që të anulohet vendimit të AKP-së – Zyra Regjionale Gjakovë “për shitjen me tender, vala 28 e privatizimit të palujtshmërive nr. 1313, 1332, 1333, 1335, 1346, 1347, 1349, 1351, 1352, 1353, 1354, 1356, 1357, 1380 dhe 1380, të gjitha me sipërfaqe të përgjithshme prej 49.20,20 ha, e të cilat gjenden në ZK C, fleta poseduese nr. 246” dhe njohjen e të drejtës së përbashkët të paditësve për ato parcela. Në të njëjtën kohë, paditësit kërkuan lëshimin e masës së ndalimit të përkohshëm “për të ndaluar veprimet procedurale të secilit subjekt, fituesit të tenderit në veçanti, me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve, të tjetërsimit në ndonjë formë apo ndërrimit të destinacionit të pronës së paluajtshme” deri në përfundimin e tërësishëm të procedurës. Si përfundim, paditësit propozuan që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadi, të anulohet vendimi i AKP-së mbi shitjen

me tender të patundshmërive të përshkruara si në padi, të vërtetohet se paditësit janë pronar të përbashkët të këtyre ngastrave kadastrale dhe që të nxjerrë aktvendim me të cilin caktohet masa e përkohshme siguroese. Në mbështetje të padisë, paditësit kanë dorëzuar dëshmitë në kopje si: Autorizimin për përfaqësim, Vërtetimin e datës 04 janar 2005 nr. 1206 lëshuara nga arkiva e Rep. së Maqedonisë, Listë poseduese e datës 14 janar 2005 nga Shkupi, Njoftimin e AKP-së lidhur me ngritjen e padisë të datës 05 nëntor 2009, Parashtrësia e paditësve e datës 28 shkurt 2010 për lëndën SCC-09-0202, Disa deklarata me dorëshkrim dhe dëshmi të tjera në mbështetje të padisë dhe masës së sigurimit.

Me 16 korrik 2010, AKP-ja parashtrroi përgjigje në kërkesën për masë të përkohshme, ku ndër të tjera tha se e njëjta konsideron se padia e paditësve se bashku me propozimin për aplikimin për masë siguroese janë parashtruar në kundërshtim me nenin 6.1 të rregullores 2008/4. Gjithashtu si kërkesëpadia ashtu edhe propozimi për masë, nuk mbështeten në asnjë bazë të vlefshme juridike për shkak se në Republikën e Kosovës nuk ekziston ligji mbi kthimin e tokave. Për rrjedhojë pronat për të cilat pretendojnë paditësit e të cilat gjenden në fletën poseduese 246 nga ana e AKP-së janë përfshirë në valën e 38 të privatizimit në emër të NSH-së “Ereniku” në Gjakovë, ndërsa që nga data 02 shkurt 2010 janë transferuar te blerësi A K. Ndër të tjera AKP-ja argumenton se paditësi nuk ka ofruar prova të besueshme se mund t’i shkaktohet dëm material i drejtpërdrejtë dhe i riparueshëm si dhe njëherit paditësi me asnjë provë nuk e ka bërë të besueshëm se padia e tij është e bazuar. Si përfundim AKP-ja propozoi që Gjykata t’a refuzojë në tërësi si të pabazuar propozimin e paditësve për caktimin e masës siguroese dhe që t’a obligon paditësin që t’iu kompensojnë shpenzimet e procedurës kontestimore. Si provë në mbështetje të pretendimeve të të paditurës, e njëjta bashkëngjiti Kontratën e shitblerjes datë 02 shkurt 2010 dhe Fletën Poseduese me nr. 246 e datës 02 janar 2010.

Me 19 korrik 2010, NSH “Ereniku” në Gjakovë, paraqiti përgjigje ndaj urdhrit të datës 06 korrik 2010, ku ndër të tjera theksoi se ngastrat kontestuese i ka pasur në posedim të qetë dhe të lirë për mbi 40 vite deri në momentin e privatizimit (vala e 38 e privatizimit), andaj padia dhe kërkesëpadia për vërtetim pronësie është vjetërsuar. Gjithashtu e paditura thekson se të gjitha ngastrat lëndore janë privatizuar nga AKP-ja përmes procedurës së rregullt të privatizimit e ku edhe kontrata me fituesin e tenderit është ratifikuar. Si përfundim përfaqësuesi i NSH-së i propozon Gjykatës që padinë, kërkesëpadinë si dhe propozimin për caktimin e masës së përkohshme t’i refuzojë si të pabazuara.

Me 13 shtator 2010, Dhoma e Posaçme pas seancës vendimmarrëse lëshoi aktvendim me të cilin palës paditëse i refuzohet kërkesa për lëshimin e masës për ndalimin e përkohshëm për arsyen se të paditurat më nuk janë në pozitë të disponojnë ngastrat e pretenduara dhe nuk janë titullarë të tyre, rrjedhimisht Gjykata mund të urdhëroj veprime të caktuara vetëm ndaj palëve në procedurë. Me anë të këtij aktvendimi gjithashtu u vendos që kjo procedurë gjyqësore të pezullohet/ndërpritët derisa gjykata të vendosë në lëndën SCC-08-0124. Me qenë se gjendet një lëndë e ndarë e cila pret pranë Dhomës së Posaçme në lidhje me statusin e të paditurës “Ereniku”, e cila është çështje preliminare në këtë lëndë, Dhoma e Posaçme konsideron se procedura në këtë lëndë duhet të ndërpritët pasi që do të jetë kundër ruajtjes së shpenzimeve. Ndër të tjera gjykata konstatoi se është në interes të drejtësisë që të përcaktohet dhe të përfundohet fillimisht çështja

e statusit e të paditurës “Ereniku” e që pastaj do të ishte e mundshme të vazhdohet me procedurën në këtë lëndë duke e marrë parasysh rezultatin e procedurës në lëndën SCC-08-0124.

Me 10 maj 2023, gjyqtari i çështjes caktoi seancë dëgjimore për datën 05 qershor 2023. Ftesën për seancën dëgjimore përfaqësuesi i paditësve e pranoi me 15 maj 2023, mirëpo i njëjti nuk prezantoi në seancë e as nuk e arsyetoj mungesën e tij.

### **Arsyetimi ligjor:**

Padia e paditësit hedhet poshtë.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Neni 58.2 i Ligjit për Dhomën e Posaçme parasheh:

*Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimt të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale.*

Meqenëse statusi i ndërmarrjes “Ereniku” ishte zgjidhur me aktgjykimin SCC-08-0124, datë 07 mars 2014, gjykata gjen se pezullimi/ndërprerja e procedurës në këtë lëndë tanimë është pa ndonjë efekt.

Dhoma e Posaçme, me urdhrin e datës 10 maj 2023, ka caktuar seancë dëgjimore në këtë çështje për datën 05 qershor 2023, në ora 13:30. Urdhri është pranuar nga përfaqësuesi i paditësve dhe nga e paditura AKP, gjë që vërtetohet nga fletë kthesat të cilat gjenden në shkresat e lëndës. Përfaqësuesi i paditësve nuk ka prezantuar në seancë. Përfaqësuesi i të paditurës AKP, i ka propozuar gjykatës që në përputhje me neni 58 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të sjell aktgjykim për mosparaqitje.

Pasi që Dhoma e Posaçme nuk ka pranuar asnjë njoftim relevant dhe në afat të arsyeshëm kohor nga pala paditëse, me të cilin do të theksonte arsyet apo rrethanat të cilat ia kanë pamundësuar prezencën e saj në seancë si dhe duke pasur parasysh kërkesën e përfaqësuesit të të paditurës AKP që të merret Aktgjykim në mungesë, kolegji vlerëson se kushtet për nxjerrjen e një aktgjykim të tillë janë plotësuar, ashtu siç janë të parapara në nenin 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj edhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **Taksat gjyqësore**

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

## **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet kërkesë për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje brenda një muaji nga pranimi i të njëjtit. Kërkesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 59 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Shkelzen Sylaj, Gjyqtar

Diellza Hoxha, Gjyqtare